

ANEKSI 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE

Dizajn, Prodhim dhe Materiale Komunikimi

Të gjitha materialet dhe shërbimet duhet të dorëzohen në përputhje me identitetin vizual dhe udhëzimet e komunikimit të miratuara të projektit. Specifikimet finale, përfshirë dizajnin, ngjyrat, dimensionet dhe formatet, do të dakordësohen me Autoritetin Kontraktor përpara prodhimit. Të gjitha produktet duhet të mbështesin aktivitetet ndërgjegjësuese që lidhen me reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe gatishmërinë emergjente, si dhe të jenë të përshtatshme për komunikim me publikun e gjerë.

Kontraktori duhet të ofrojë shërbime të vazhdueshme të dizajnit grafik dhe komunikimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës. Shërbimi duhet të sigurojë zhvillimin e materialeve vizuale të qarta, të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë, të përshtatshme për fushata ndërgjegjësimi, duke përfshirë krijimin e koncepteve vizuale, përgatitjen e file-ve të gatshme për printim, përshtatjen e materialeve për formate dhe audienca të ndryshme, si dhe integrimin e elementeve si kodet QR kur kërkohet. Kontraktori duhet të sigurojë disponueshmëri të vazhdueshme, dorëzim në kohë të materialeve të kërkuara dhe zbatimin e rishikimeve bazuar në komentet e Autoritetit Kontraktor. Të gjitha materialet duhet të zhvillohen duke përdorur programe profesionale dizajni dhe të dorëzohen si në formate të editueshme, ashtu edhe në formate finale, në përputhje me standardet teknike të zbatueshme.

◆ MATERIALE TË PRINTUARA

Fletë Informuese (Factsheets)

Fletët informuese duhet të printohen në të dyja anët (para dhe mbrapa) me ngjyra të plota (CMYK), në letër me peshë minimale 200 gsm. Përfundimi duhet të jetë glossy ose luster. Printimi duhet të realizohet me rezolucion minimal 300 DPI për të siguruar cilësi të lartë.

Flyers B5

Flyers në format B5 duhet të printohen në të dyja anët (para dhe mbrapa) me ngjyra të plota (CMYK). Printimi duhet të jetë me cilësi të lartë (minimumi 300 DPI), me përfundim luster ose ekuivalent. Dizajni duhet të sigurojë qartësi dhe lexueshmëri.

Flyers (10 cm x 15 cm)

Flyers me përmasa 10 cm x 15 cm duhet të printohen me ngjyra të plota (CMYK), në letër me peshë minimale 300 gsm, me përfundim luster. Çdo flyer duhet të përbëhet nga një fletë e printuar në të dyja anët. Printimi duhet të realizohet me rezolucion minimal 300 DPI.

Flyers A5

Flyers në format A5 duhet të printohen në të dyja anët (para dhe mbrapa) me ngjyra të plota (CMYK), në letër me peshë minimale 250–300 gsm, me përfundim matte ose luster. Printimi duhet të realizohet me rezolucion minimal 300 DPI.

Mini Broshurë

Printim me ngjyra të plota, letër 200–300 gsm, format i palosur, përfundim profesional.

Postera Infografikë

Posterat infografikë duhet të dizajnohen për të paraqitur informacion kyç mbi reduktimin e riskut nga fatkeqësitë dhe gatishmërinë emergjente në një format të qartë dhe të strukturuar vizualisht, duke përdorur ikona, ilustrime dhe tekst të shkurtër. Përmbajtja duhet të përfshijë udhëzime praktike (p.sh. veprimet para, gjatë dhe pas emergjencave). Posterat duhet të prodhohen në format A2 ose A3, të printuar me ngjyra të plota (CMYK) në letër 170–250 gsm, me rezolucion minimal 300 DPI. Kodet QR mund të përfshihen sipas nevojës.

Kartat Emergjente

Kartat emergjente duhet të dizajnohen si materiale kompakte dhe të lehta për përdorim, duke ofruar informacion thelbësor për situata emergjente, përfshirë udhëzime bazë dhe informacion kontakti kyç. Kartat duhet të prodhohen në format A6 ose format xhepi, të printuara në të dyja anët me ngjyra të plota (CMYK) në letër 300–350 gsm dhe të laminuara për qëndrueshmëri. Kodet QR mund të përfshihen sipas nevojës.

Kalendari

Tip muri ose tavoline, printim me ngjyra të plota, letër 200–300 gsm, 12 muaj plus kopertinë, lidhje me spirale, me branding.

◆ MATERIALE PROMOVUESE

Kapele

Material pambuku ose poliesteri, branding i printuar ose i qëndisur, qepje rezistente, dhe perpunim cilesor per qendrueshmeri dhe te pershtatshme per perdorim te perditshem ne ambiente te jashtme. Modele praktike dhe komode. Te disponueshme me system rregullimi per pershtatje optimale.

Çanta

Material pambuku (minimumi 140–200 gsm), doreza të përforcuara për mbajtje të sigurt dhe të

Tote

komoditet gjat transportit, branding i printuar (screen print ose sublimation). Dizajn praktik dhe funksional me hapësirë të mjaftueshme për transportin e sendeve të ndryshme

Bllaqe Shënimesh (A5)

Rreth 50 faqe, preferohet letër e ricikluar, lidhje me spirale, kopertinë me ngjyra të plota.

Filxhanë

Material qeramike, printim sublimation, kapacitet standard (~300 ml). Material rezistent ndaj përdorimit të përshtatshëm për pije të nxehta dhe të ftohta, i lehtë për tu pastruar.

Mbajtëse Gotash

Material tapë ose material ekologjik, rezistente ndaj ujit dhe nxehtësisë, branding i printuar.

Bluza

100% pamuk, prerje standarde, branding i printuar (screen print). Material që lejon qarkullimin e ajrit, Pelhure rezistente dhe që ruan formën dhe cilësinë e printimit

Stilolapsa

Material plastik ose metalik, logo e printuar. Dizajn ergonomic dhe praktik për përdorim të përditshëm. Material rezistent që siguron jetgjatësi.

Jelekë

Material rezistent, i përshtatshëm për përdorim të përditshëm, xhepa të jashtëm, branding i printuar ose i qëndisur. Dizajne praktike dhe funksionale.

Shishe Termosi

Material Çelik inox, rezistente ndaj korrozionit dhe përdorimit të përditshëm branding i printuar ose i gdhendur. Model modern dhe ergonomic, i përshtatshëm për transport. Të jenë të disponueshme në kapacitete të ndryshme në varesi të kërkesës.

◆ MATERIALE PËR EVENTE

Tendë

Strukturë metalike, material rezistent ndaj ujit, branding i plotë i jashtëm. Printim me rezolucion të lartë për paraqitje profesionale dhe dukshmeri optimale. Struktura praktike për transport dhe magazinim të lehtë.

Stenda Promovuese

Strukturë portative të lehtë për transport montim dhe çmontim të lehtë, elemente vizuale të printuara. Ngjyra të gjalla dhe rezolucion i lartë për tërheqjen e vëmendjes dhe komunikim efektiv të markes. Struktura stabile dhe rezistente për përdorim të përsëritur në ambiente të brendshme dhe të jashtme.

Banera Roll-up

Madhësi standarde (85x200 cm), strukturë alumini, printim me ngjyra të plota, kod QR i përfshirë sipas nevojës.

Flamuj, Flyer

Material tekstil për flamur – rezistent, prerje në të ftohtë, pa PVC, i riciklueshëm (opsional), në përputhje me standardin REACH dhe me transparencë të shkëlqyer.

Shtylla e flamurit me fibër të plotë është rezistente, e lehtë dhe mund të përballojë shpejtësinë e erës.

I përshtatshëm si për përdorim të brendshëm, ashtu edhe për përdorim të jashtëm.

◆ STANDARDET E CILËSISË

Të gjitha materialet duhet të përmbushin standardet minimale të cilësisë, duke përfshirë printim me rezolucion të lartë (minimumi 300 DPI), riprodhim të saktë të ngjyrave në formatin CMYK, tekst dhe grafikë të qartë dhe të lexueshme, si dhe qëndrueshmëri të përshtatshme për përdorimin e tyre të synuar.

◆ KONTROLLI I CILËSISË

Kontraktori duhet të paraqesë mostra për miratim përpara prodhimit në masë. Prodhimi do të vazhdojë vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktor. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të refuzojë materialet që nuk përmbushin specifikimet e kërkuara.

◆ PAKETIMI DHE DORËZIMI

Të gjitha materialet duhet të pakëtohen në mënyrë të përshtatshme për të parandaluar dëmtimet gjatë transportit dhe të dorëzohen brenda afateve të dakordësuara.